



Republika e Kosovës - Republika Kosova  
*Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtesa*  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

# *UDHËZUES PËR ANKESA DHE APELE*

*Zgjedhjet*

*[pzap.rks-gov.net](http://pzap.rks-gov.net)*



# PËRGJIGJE TË SHPEJTA

## 1. ÇFARË ËSHTË PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHITRESA (PZAP)?

PZAP është institucioni i përhershëm dhe i pavarur përgjegjës për të vendosur për ankesat dhe apelet që kanë të bëjnë me procesin zgjedhor. PZAP përbëhet nga 10 anëtarë gjyqtarë duke përfshirë edhe Kryesuesin, të cilët emërohen nga Kryetari i Gjykatës Supreme.

## 2. KUSH KA TË DREJTË TË ANKOHET?

Të gjithë qytetarët me të drejtë vote, përfaqësuesit e subjekteve politike, komisionerët e vendvotimeve dhe vëzhguesit vendor kanë të drejtë të ankohen.

## 3. SI DUHET TË DORËZOHET NJË ANKESË?

Dorëzimi i ankesave është process shumë i lehtë. Këta janë hapat që duhet ndjekur:

- Hapi 1: Gjeje një formularë të PZAP (mund të gjendet në uebfaqe të PZAP ose në çdo qendër të votimit). Nëse nuk gjen formular, shkruaje ankesën në një fletë të thjeshtë.
- Hapi 2: Shkruaj këto informata në ankesë: emrin dhe kontaktet e juaja, përshkrimin e shkeljes së supozuar, datën, kohën, vendin e ngjarjes. Konfirmo vërtetësinë e përmbajtjes së ankesës. Nëse ka mundësi, shëno edhe emrin dhe kontaktet e personit që e ka bërë shkeljen e supozuar. Mos harro që ta nënshkruash ankesën.
- Hapi 3: Bashkangjit dëshmi siç janë: ndonjë dokument relevant, fotografi, video/audio inqizim, ose dëshmi tjetër. Shkruaj emrin dhe kontaktet e dëshmitarëve, nëse ka.
- Hapi 4: Sigurohu që ta dorëzosh ankesën me kohë: për ankesat lidhur me periudhën e fushatës brenda 72 orëve nga ngjarja, për ankesat lidhur me ditën e zgjedhjeve brenda 24 orëve nga mbyllja e vendvotimeve, për ankesat lidhur me Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve brenda 24 orëve nga ngjarja.
- Hapi 5: Dorëzoje ankesën në kutinë postale ose zyrën e PZAP-së në këtë adresë:  
Rr. Luan Haradinaj p.n. Prishtinë, Kosovë, 10000.

## 4. ME ÇFARË KORNIZE LIGJORE PUNON PZAP?

PZAP punën në përputhje me këto ligje dhe rregullore: Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme, Ligjin për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, Ligjin për Zgjedhjet Lokale, Rregullat dhe Procedurat e PZAP, Rregulla mbi Kategoritë e Dënimeve dhe Gjobjave, si dhe Rregulloret e KQZ-së.

# PËRMBAJTJA

|  |           |
|--|-----------|
| HYRJE .....                                  | 5         |
| <b>1. PROCEDURAT E ANKIMIMIT.....</b>        | <b>6</b>  |
| 1.1 PROCESI I ANKIMIMIT.....                 | 6         |
| Çfarë është ankesa?.....                     | 6         |
| Kush ka të drejtë të ankohet?.....           | 6         |
| Si duhet të dorëzohet ankesa?.....           | 6         |
| Çfarë duhet të përmbajë një ankesë?.....     | 7         |
| Ku mund ta dorëzoni ankesën?.....            | 7         |
| Kur duhet të dorëzohet ankesa?.....          | 7         |
| 1.2 SHËNIMI NË LIBRIN E VOTIMIT.....         | 8         |
| <b>2. JURISDIKSIONI I PZAP.....</b>          | <b>9</b>  |
| 2.1 KORNIZA LIGJORE.....                     | 9         |
| 2.2 ANKESAT.....                             | 10        |
| 2.3 APELET.....                              | 10        |
| 2.4 PËRCJELLJA E RASTEVE.....                | 11        |
| 2.5 FUQITË E PZAP.....                       | 12        |
| <b>3. DËNIMET E MUNDSHME.....</b>            | <b>13</b> |
| 3.1 SHKELJET ZGJEDHORE.....                  | 13        |
| 3.2 KRIMI NË ZGJEDHJE.....                   | 17        |
| ANEKSI A: FORMULARI I ANKESAVE.....          | 20        |
| ANEKSI B: DIAGRAMI PËR ANKESA DHE APELE..... | 21        |

Me 3 Nëntor 2013, votuesit e Kosovës do të kenë mundësi të hedhin votën e tyre në zgjedhjet për Kuvende Komunale dhe për Kryetarë Komunash. Raundi i dytë i zgjedhjeve gjithashtu pritet të mbahet me 1 Dhjetor në të gjitha komunat ku kandidatët për kryetarë nuk fitojnë zgjedhjet (50% +1) në raundin e parë. Këto zgjedhje do të organizohen në përputhje me kornizën ligjore aktuale, konkretisht Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme (LZP), Ligjit për Ndryshimin dhe Shtimin e LZP, si dhe Ligjin për Zgjedhjet Lokale.

Si institucion i pavaruar i themeluar nga LZP, Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa është i përkushtuar që të përmbush mandatin ligjor dhe të vendos për ankesat dhe apelet e lejuara në lidhje me procesin zgjedhor. Mundësia për t'u ankuar apo apeluar është një mekanizëm shumë i rëndësishëm që e mbron procesin zgjedhor. Çdo votues dhe subjekt politik ka të drejtë ta mbrojë ligjin dhe të ankohet në rast se shkelen të drejtat e tyre zgjedhore. PZAP punon në mënyrë të pa-anshme dhe të pavarur në trajtimin e ankesave dhe apeleve zgjedhore konform kornizës ligjore në Kosovë dhe standardeve ndërkombëtare mbi zgjedhjet.

PZAP përbëhet nga dhjetë (10) anëtarë gjyqtarë duke përfshirë edhe Kryetarin, i cili emërohet nga Kryetari i Gjykatës Supreme. Kryetari emërohet nga radhët e gjyqtarëve të Gjykatës Supreme, ndërsa anëtarët e tjerë nga gjyqtarët e Gjykatave të Qarkut. Gjatë trajtimit të ankesave dhe apeleve, PZAP vendos panele të përbëra nga tre (3) gjyqtarë ashtu siç përcaktohet nga Kryetari. Puna e PZAP-së lehtësohet nga stafi i Sekretariatit, të cilët janë përgjegjës për pranimin e ankesave, hetimin e rasteve, arkivimin e materialeve dhe aktiviteteve të tjera administrative.

Gjatë përvojës nga zgjedhjet e kaluara, ne e kemi parë të rëndësishme informimin e akterëve rreth procesit të ankesave dhe apeleve. Subjektet politike, kandidatët, trupat menaxhues të zgjedhjeve dhe vëzhguesit duhet kuptojnë si të dorëzojnë ankesa, çfarë dëshmi duhet pasur në mbështetje të ankesës, cili institucion është përgjegjës për trajtimin e tyre dhe çfarë dënime apo gjopa mund të vendosen ndaj atyre që e shkelin ligjin dhe rregullat e zgjedhjeve. Për këtë arsye, PZAP ka vendosur që të shpërndaj këtë udhëzues për akterët kyç në proces zgjedhor, qëllimet e të cilit janë:

1. Informimi mbi procedurat e ankimit
2. Informimi mbi fuqinë juridike të PZAP-së
3. Informimi mbi dënimet dhe gjogat e mundshme

Ky udhëzues përbëhet nga tre kapituj, secili prej tyre përkon me njërin nga qëllimet e përmendura më lartë. PZAP shpreson që ky udhëzues të i përmbush nevojat e juaja për informacione rreth procesit të ankesave dhe apeleve, dhe që do të iu ndihmojë që të mbron integritetin e procesit zgjedhor.

*Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa*

# 1. PROCEDURAT E ANKIMIMIT

## 1.1. PROCESI I ANKIMIMIT

Dorëzimi i ankesave që kanë të bëjnë me shkeljet zgjedhore është një proces i lehtë, megjithatë është e nevojshme që të kuptohen elementet kryesore që një ankesë duhet të përmbajë. Ankesa duhet të dorëzohet në përputhje me kriteret e përcaktuara në Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe rregullat e PZAP-së. Shpesh herë kriteret për parashtrimin e ankesave nuk përmbushen, duke rezultuar në hidhjen poshtë të ankesave nga PZAP-i gjatë trajtimit fillestarë. Një ankesë mund të hidhet poshtë nga PZAP-i për arsye të ndryshme p.sh. nëse nuk është dorëzuar në kohën e duhur, nuk posedon informatat kryesore ose nuk ka të bëjë me shkelje në zgjedhje.

Edhe në qoftë se një ankesë kalon fazën e shqyrtimit fillestarë dhe konsiderohet për trajtim të mëtejshëm, shpesh PZAP përballlet me vështirësi në gjykimin e ankesave për shkak që nuk ka dëshmi të mjaftueshme në lidhje me shkeljen e supozuar. Sekretariati i PZAP-së i heton rastet me mundësitë dhe kapacitetet që i ka, megjithatë mungesa e dëshmive ose informatava që drejtojnë për në dëshmi, mbetet sfida kryesore. Është shumë e rëndësishme që subjektet politike, trupat menaxhuese zgjedhore, vëzhguesit dhe votuesit në përgjithësi të kuptojnë procedurat dhe informatat e nevojshme për dorëzimin e ankesave:

### **ÇFARË ËSHTË ANKESA?**

Ankesa është një shkelje e supozuar e ligjeve apo rregullave zgjedhore, e dorëzuar me shkrim nga një person që ka interes ligjor apo të drejtat e të cilit janë dëmtuar gjatë procesit zgjedhor.

### **KUSH KA TË DREJTË TË ANKOHET?**

Të gjithë qytetarët me të drejtë vote, përfaqësuesit e subjekteve politike, komisionerët e vendotimeve dhe vëzhguesit vendor kanë të drejtë të ankohen.

### **SI DUHET TË DORËZOHET ANKESA?**

Që një ankesë të konsiderohet për hetime të mëtutjeshme, duhet të:

- Dorëzohet nga një person i cili ka të drejtë të ankohet.
- Dorëzohet brenda afatit kohor (shih më poshtë).
- Dorëzohet me shkrim duke plotësuar formularin e PZAP-it (Aneksi A) që mund të merret në Sekretariatit e PZAP-së, në ueb-faqen e PZAP-së dhe gjithashtu në të gjitha qendrat e votimit në ditën e zgjedhjeve. Ankesa mund të shkruhet edhe në letër të thjeshtë përdërisa përmbanë detajet që duhet të përmbajë një ankesë (shih më poshtë).

- d) Referoj dispozitat që janë shkelur në Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme, Ligjin mbi Zgjedhjet Lokale apo rregullat e KQZ-së.
- e) Jetë e nënshkruar nga personi që ka dorëzuar ankesën.

### **ÇFARË DUHET TË PËRMBAJË NJË ANKESË?**

Ankesa që dorëzohet në PZAP duhet të përmbajë:

- a) Emrin, adresën dhe kontaktet e personit i cili është ankuar;
- b) Përshkrimin e detajuar të shkeljes së supozuar, përfshirë edhe datën, kohën dhe vendin e ngjarjes;
- c) Detajet lidhur me ndonjë dëshmi, ndonjë kopje të ndonjë dokumenti relevant, fotografi, video/audio inqizim, apo lloje të tjera të dëshmive që mbështesin ankesën, apo ndonjë udhëzim se ku mund të gjendet dëshmia, nëse nuk është në posedim të ankuesit.
- d) Vërtetimin nga ankuesi për vërtetësinë e përmbajtjes së ankesës.

Aty ku është e mundur, ankesa duhet gjithashtu të sigurojë:

- a) Emrin, adresën dhe kontaktet (nëse ato ekzistojnë) e personit që ka kryer shkeljen e supozuar;
- b) Emrin, adresën dhe kontaktet (nëse ato ekzistojnë) të ndonjë dëshmitari.

### **KU MUND TA DORËZONI ANKESËN?**

Ankesa duhet të dorëzohet në kutinë postare ose në zyrë të PZAP-së, në adresën rr. Luan Haradinaj Prishtinë, Kosovë 10000.

### **KUR DUHET TË DORËZOHET ANKESA?**

Afate të ndryshme kohore aplikohen për ankesa të procesit zgjedhor:

- a) Ankesat që nuk kanë të bëjnë me procesin e votimit dhe numërimit të votave, sikurse, ankesat në lidhje me fushatat politike dhe financave, shkeljet e kodit të mirësjelljes, të mediave dhe të tjera duhet të dorëzohen brenda shtatëdhjetë e dy (72) orëve nga momenti kur shkelja e supozuar ka ndodhur.
- b) Ankesat që kanë të bëjnë me procedurat e votimit apo numërimit gjatë ditës së zgjedhjeve, duhet të dorëzohen në PZAP brenda njëzet e katër (24) orëve pas mbylljes së votimit.
- c) Ankesat lidhur me procedurat në Qendër të Numërimit dhe Rezultateve (QNR), duhen të dorëzohen brenda njëzet e katër (24) orëve nga momenti kur shkelja e supozuar ka ndodhur.

**E rëndësishme:** Vetëm dorëzimi i ankesës në kohën e duhur është e obligueshme.

Ankuesit mund t'i jepet më shumë kohë nga PZAP për të siguruar dëshmi për shkeljen e supozuar.

## 1.2. SHËNIMI NË LIBRIN E VOTIMIT

Çdo vendvotim është i pajisur me nga një libër të votimit, në të cilin shënohen ngjarjet e rëndësishme në lidhje me procesin e votimit. Zakonisht libri i votimit është i mbushur me informata siç janë: koha e fillimit të votimit, detajet e vëzhguesve të cilët janë të pranishëm në vendvotim, problemet me identifikimin e votuesve, incidentet serioze dhe mbyllja e votimit. Mirëpo libri i votimit nuk është i kufizuar në këto informata. Këshillat e vendvotimit dhe vëzhguesit e akredituar mund të shkruajnë ngjarje të rëndësishme rreth procesit të votimit apo të numërimit.

Votuesve nuk iu lejohej që të bëjnë shënime në Librin e Votimit, por në qoftë se ata kanë ndonjë ankesë lidhur me procedurat brenda vendvotimit, ata mund të kërkojnë nga kryesuesi që të shënoj ankesën në librin e votimit<sup>1</sup> dhe pastaj të dorëzojnë ankesë zyrtare në PZAP. Po ashtu, nëse një anëtar i këshillit të vendvotimit kundërshton rezultatet e regjistruara në vendvotim, ata mund të shënojnë vërejtjen e tyre në librin e votimit.

Gjatë hetimit të ndonjë ankesë që ka të bëjë me ditën e zgjedhjeve, nëse parashtruesi i ankesës ka dhënë udhëzime, PZAP mund t'i referohet librit të votimit për informata më të hollësishme apo dëshmi. Informatat e shënuara në librin e votimit mund të rezultojnë në gjykim më efektiv të ankesave.

---


<sup>1</sup> Neni 94, Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme.



## 2. JURISDIKSIONI I PZAP

### 2.1. KORNIZA LIGJORE

Diagrami i mëposhtëm shpjegon kornizën ligjore për procesin e ankesave dhe apeleve. PZAP punon në pajtueshmëri me dispozitat e këtyre ligjeve dhe rregullave.



## 2.2. ANKESAT

PZAP ka mandat ligjor që të vendos për ankesat në lidhje me këto çështje:

| #   | LLOJI I ANKESËS   | BAZA LIGJORE   |
|-----|---|----------------|
| 1.  | Nëse subjekti politike jep informata të pavërteta rreth përshtatshmërisë së kandidatëve;  | Neni 29.9 LZP  |
| 2.  | Nëse subjekti politik shkelë Kodin e Mirësjelljes;  | Neni 32.2 LZP  |
| 3.  | Nëse subjekti politik nuk dorëzon raportin për financa në afatin e përcaktuar kohor, ose nëse e dorëzon të pa-plotësuar ose të pa-saktë.  | Neni 40.5 LZP  |
| 4.  | Mosmarrëveshjet në lidhje me ngjarjet politike në vende publike.  | Neni 44.2 LZP  |
| 5.  | Shkeljet e Kapitullit të LZP mbi Mediat gjatë Fushatës.   | Neni 51.1 LZP  |
| 6.  | Nëse anëtarët e Këshillave të vendotimeve të nominuar nga subjektet politike apo OJQ-të nuk i ndjekin trajnimet dhe nuk përmbushin detyrat e tyre në vendotim sic udhëzohen nga Komisioni Komunal Zgjedhor. | Neni 80.3 LZP  |
| 7.  | Nëse subjekti politik nuk ka larguar materialet e fushatave apo është parë duke vendosur materiale në largësi prej 100m nga vendotimi apo qendra e votimit, brenda 25 orëve para fillimit të votimit.       | Neni 85.1 LZP  |
| 8.  | Nëse ndonjë anëtarë i këshillit të vendotimit ka vërejtje rreth rezultateve të shënuara për vendotim.   | Neni 102.1 LZP |
| 9.  | Administrimi I procesit të numërimit në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR).  | Neni 105.1 LZP |
| 10. | Personat të cilëve iu janë shkelur të drejtat në proces zgjedhor.   | Neni 119.1 LZP |

## 2.3. APELET

PZAP ka mandat ligjor që të vendos për apelet në lidhje me këto çështje:

| #  | LLOJI I APELIT  | BAZA LIGJORE  |
|----|---|---------------|
| 1. | Apel mbi vendimin e KQZ-së për refuzim të aplikacionit për certifikim të subjektit politik.           | Neni 16.5 LZP |
| 2. | Apel mbi vendimin e KQZ-së për refuzimin e certifikimin e listës së kandidatëve të subjektit politik. | Neni 26.6 LZP |

|    |   |                |
|----|---|----------------|
| 3. | Apel mbi vendimin e KQZ-së për të refuzuar akreditimin e ndonjë personi apo organizate si vëzhgues në zgjedhje. | Neni 54.7 LZP  |
| 4. | Apel në lidhje me procedurat në vendvotim.  | Neni 94.2 LZP  |
| 5. | Apel në lidhje me pranimin apo refuzimin për të marrë pjesë si votues jashtë Kosovës.                           | Neni 98.2 LZP  |
| 6. | Apel mbi vendimet e KQZ-së të përmendura në nenin 122 të LZP-së.  | Neni 122.1 LZP |

## 2.4. PËRCJELLJA E RASTEVE

Edhe pse është institucioni kryesor për të gjitha ankesat dhe apelet lidhur me zgjedhjet, PZAP është e obliguar që të përcjell disa lloje të ankesave dhe apeleve tek institucionet e tjera të cilat kanë mandat ligjor që të vendosin për ato raste. Kjo nuk nënkupton që PZAP i refuzon këto ankesa. Përkundrazi, PZAP shërben si pika e parë për dorëzimin e ankesave dhe apeleve lidhur me zgjedhjet, përderisa përcjellja e rasteve është pjesë e përgjegjësisë ligjore dhe institucionale. Më poshtë, është një tabelë që përshkruan llojet e ankesave apo apeleve të cilat PZAP i përcjell tek institucionet e tjera:

| LLOJI I ANKESËS  |   | VEPRIMI I PZAP  |
|--|---|---|
| Nëse ankesa e supozuar nuk përmban një shkelje të ligjeve dhe rregullave zgjedhore.                                | → | PZAP e hidhë poshtë ankesën si të palejuar.   |
| Nëse ankesa e supozuar ka të bëjë me pranimin apo refuzimin e votuesve në Listën e Votuesve.                       | → | PZAP e përcjell rastin tek Gjykata e Shkallës së Parë (Neni 9 & 10 LZP)   |
| Nëse ankesa e supozuar ka të bëjë me shkeljet nga mediat publike.  | → | PZAP e përcjell ankesën tek Komisioni i Pavarur i Mediave (Neni 51.1 & 51.2 LZP).   |
| Nëse ankesa e supozuar ka të bëjë me krimet në zgjedhje siç parashihet në Kapitullin 18 të Kodit Penal të Kosovës. | → | PZAP e përcjell ankesën në Prokurorinë e Shtetit (neni 1.12 Rregullat dhe Procedurat PZAP).   |
| Nëse ankesa e supozuar ka të bëjë me shkelje zgjedhore mirëpo edhe me krim zgjedhor sipas Kodit Penal.             | → | PZAP e pranon ankesën për ndonjë gjobë të mundshme për subjektin politik, dhe mund ta përcjell rastin në Prokurorinë e Shtetit për hetime të mëtejshme (Neni 38, 46 dhe 120.5 LZP). |

## 2.5. FUQITË E PZAP

Ekzistojnë disa nene përgjatë Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme që i përcaktojnë fuqitë e PZAP:

1. Gjykon ankesat nga vendimi i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) lidhur me:
  - a) Përfshirjen ose largimin e një personi për të marrë pjesë në programin votues brenda dhe jashtë Kosovës
  - b) certifikimin ose kundërshtimin për të certifikuar një subjekt politik ose kandidat për të marrë pjesë në zgjedhje
  - c) kandidatin i cili pas certifikimit nuk dëshiron të marrë pjesë në zgjedhje
  - d) akreditimin ose refuzimin për akreditim të një vëzhguesi zgjedhor
  - e) vendosjen e një gjobe administrative ndaj një subjekti politik sipas nenit 42 të këtij ligji
  - f) refuzimin për të regjistruar një parti politike brenda Zyrës. [LZP Neni 122.1]
2. Mund të urdhërojë rinumërimin e fletëvotimeve në një vendvotim apo qendërvotimi si dhe shqyrtimin e materialit votues si pjesë të hetimeve për ankesën ose apelin. [LZP Neni 117.4]
3. Vendos rregullat dhe procedurat e saj. [LZP Neni 117.1]
4. Kërkoj nga të gjitha autoritetet Kosovare t'i ofrojnë tërë ndihmën e nevojshme gjatë procesit zgjedhor. [LZP Neni 116.2]
5. Urdhërojë një subjekt politik ose një organizatë vëzhguese të ndërmarrë masa përmirësuese. [LZP Neni 120.1]
6. Para certifikimit të rezultateve zgjedhore, është në kompetencë të PZAP-it, në raste të jashtëzakonshme të anulojë rezultatet në një vendvotim apo qendër votimi, dhe ta urdhërojë KQZ-ën ti përsërisë votimin në një qendër votimi apo vendvotim, nëse konsideron se ka ndikim në rezultatet finale. [LZP Neni 120.1]
7. Të vendosë një gjobë ndaj një subjekti politik në vlerë deri në pesëdhjetëmijë euro (50,000) Euro. [LZP Neni 120.1]
8. Largojë një kandidat nga lista e kandidatëve, kur të dëshmohet se kandidati ishte përgjegjës për këtë shkelje. [LZP Neni 120.3]
9. Largojë një apo disa kandidatë nga lista e kandidatëve të një subjekti politik dhe të mos e lejoj subjektin politik t'i zëvendësojë kandidatët e larguar, nëse KZAP-i përcakton se subjekti ishte përgjegjës për këtë shkelje. [LZP Neni 120.3]
10. Decertifikojë një subjekt politik nga pjesëmarrja në zgjedhje. [LZP Neni 120.3]
11. Ndalojë një individ të marr pjesë në zgjedhjet e mbajtura nën autoritetin e KQZ-së, si kandidat apo edhe si pjesë administrative e ndonjë organi zgjedhor, për një periudhë kohore që nuk i kalon gjashtë (6) vite. [LZP Neni 120.3]

## 3. DËNIMET E MUNDSHME

### 3.1. SHKELJET ZGJEDHORE

Subjekteve politike që garojnë në zgjedhje iu ndalohet të ndërmarrin veprime që janë në kundërshtim me Kodin e Mirësjelljes dhe që shkelin dispozitat ligjore, duke përfshirë rregullat e KQZ-së. Rregulla nr. 01/2012 mbi Kategoritë e Dënimeve dhe Gjjobave i përcakton dënimet që janë të mundshme për shkeljet zgjedhore. PZAP vendos gjoba më të rënda për subjektet politike të cilat janë të përfaqësuara në Kuvedin e Kosovës, në krahasim me subjektet që nuk janë të përfaqësuara në Kuvend. Vendosja e ndonjë gjobe apo sanksioni nga PZAP është pa paragjykim ndaj ndonjë sanksionimi penal<sup>2</sup> që mund të vendoset nga institucionet tjera. Vendimet e PZAP-së publikohen menjëherë në uebfaqen e PZAP-së. Gjatë përcaktimit të gjjobave apo sanksioneve, panelet vendim-marrëse sigurohen që sanksioni të jetë në përputhje me shkeljen e bërë.<sup>3</sup> Gjjobat mund të jenë më të lehta nëse subjekti politike e vërteton ose ka bërë përpjekje për evitimin e shkeljes së supozuar.

| Veprimet e Ndaluar  | Gjjoba për Subjektet Politike që përfaqësohen në Kuvend | Gjjoba për Subjektet Politike që nuk përfaqësohen në Kuvend |
|---|---|---|
| Në qoftë se subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij bëjnë heqjen, mbulimin, dëmtimin ose ndryshimin e ndonjë njoftimi, pllakati, posteri ose materiali tjetër i cili përdoret për qëllim të fushatës zgjedhore nga ana e një subjekti tjetër politik.   | Minimum: 5,100 €<br>Maksimum: 20,000 €                  | Minimum: 5,010 €<br>Maksimum: 10,000 €                      |
| Në qoftë se subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij bëjnë vendosjen e njoftimeve, pllakateve dhe posterëve, ose përndryshe, vendosja e emrave të tyre ose sloganeve në lidhje me fushatën zgjedhore brenda ose jashtë ndërtesave publike ose godinave, në apo mbi rrugët publike, në shenjat publike të trafikut, brenda ose jashtë hapësirave ose ndërtesave të zëna ose ndryshe, që shfrytëzohen nga organizatat ndërkombëtare, ose brenda hapësirave private pa lejen e pronarëve ose shfrytëzuesve. | Minimum: 5,100 €<br>Maksimum: 20,000 €                  | Minimum: 5,010 €<br>Maksimum: 10,000 €                      |

<sup>2</sup> Neni 120.5 Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme.

<sup>3</sup> PZAP Rregullat dhe Procedurat 6.10

|   |   |   |
|---|---|---|
| Në qoftë se subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij pa lejen paraprake ose autorizimin e organit kompetent, mbajnë ose ekspozojnë armë të secilit lloj gjatë tubimeve politike ose gjatë çfarëdo lloj ngjarjeje që ka lidhje me aktivitetet e subjekteve politike.  | Minimum: 10,000 €<br>Maksimum: 30,000 € | Minimum: 10,000 €<br>Maksimum: 30,000 € |
| Në qoftë se subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij bëjnë çrregullimin e tubimeve të subjekteve tjera politike ose nxitjen e të tjerëve për një veprim të tillë.  | Minimum: 10,000 €<br>Maksimum: 30,000 € | Minimum: 10,000 €<br>Maksimum: 30,000 € |
| Në qoftë se subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij pengojnë ose tentojnë të pengojnë gazetarët për të përmbushur detyrat e tyre profesionale.  | Minimum: 5,100 €<br>Maksimum: 20,000 €  | Minimum: 5,010 €<br>Maksimum: 10,000 €  |
| Në qoftë se subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij premtojnë ndonjë shpërblim financiar më qëllim të përfuturit të mbështetjes së votuesve.  | Minimum: 5,100 €<br>Maksimum: 20,000 €  | Minimum: 5,010 €<br>Maksimum: 10,000 €  |
| Në qoftë se subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, kërcënojnë ose tentojnë për të kërcënuar subjektet tjera politike, përkrahësit ose kandidatët e tyre.  | Minimum: 10,000 €<br>Maksimum: 30,000 € | Minimum: 10,000 €<br>Maksimum: 30,000 € |
| Në qoftë se subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij nxisin cilindo person për të votuar në zgjedhje, i cili nuk ka të drejtë vote.  | Minimum: 10,000 €<br>Maksimum: 30,000 € | Minimum: 10,000 €<br>Maksimum: 30,000 € |
| Në qoftë se subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij nxisin cilindo person për të votuar më shumë se një herë në të njëjtat zgjedhje ose të votojë në emër të personit tjetër.   | Minimum: 10,000 €<br>Maksimum: 30,000 € | Minimum: 10,000 €<br>Maksimum: 30,000 € |
| Në qoftë se subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij abuzojnë me të drejtën e ankesës, ose duke bërë ankesa ose paraqitje të rrejshme, të pavlera dhe irrituese në PZAP.   | Minimum: 5,100 €<br>Maksimum: 20,000 €  | Minimum: 5,010 €<br>Maksimum: 10,000 €  |
| Në qoftë se subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij përdorin gjuhën, në formë të shkruar ose gojore, që nxit ose provokon, ose që mund të nxisë ose provokojë, një person tjetër për të kryer një akt të dhunës kundër personave tjerë ose pasurisë, ose e cila nxit apo mund të nxisë urrejtje kundrejt të tjerëve, ose duke publikuar ose përdorur fotografi, simbole ose çfarëdo lloj materiali tjetër që ka ose mund të ketë ndikim të tillë. | Minimum: 10,000 €<br>Maksimum: 30,000 € | Minimum: 10,000 €<br>Maksimum: 30,000 € |

|   |   |   |
|---|---|---|
| <p>Në qoftë se subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij me qëllim të promovimit të subjektit politik ose kandidatëve të tij, duke përdorur fotografi, simbole ose çfarëdo lloj materiali i cili i referohet personit i cili:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Është në vuajtje të dënimit të shqiptuar nga Tribunali Penal Ndërkombëtar për ish Jugosllavinë ; ose</li> <li>• Ka padi të ngritur nga Tribunali dhe i cili nuk i është përmbajtur urdhrin për t'u paraqitur para Tribunalit,</li> </ul> | <p>Minimum: 10,000 €<br/>Maksimum: 30,000 €</p> | <p>Minimum: 10,000 €<br/>Maksimum: 30,000 €</p> |
|---|---|---|

### Frikesimi dhe Dhuna Gjate Procesit Zgjedhor

|   |   |  |
|---|---|--|
| <p>Përdorimi ose kërcënim i përdorimit të dhunës së çfarëdo lloji nga subjekti politik, anëtarët, mbështetësit ose kandidatët e tyre, ndalohet rreptësisht.</p> | <p>Minimum: 10,000 €<br/>Maksimum: 50,000 €</p> | <p>Minimum: 9,000 €<br/>Maksimum: 40,000 €</p> |
| <p>Subjektit politik ose kandidatit iu ndalohet, inkurajimi, mbështetja ose miratimi i dhunës, kërcënimit me dhunë ose kanosjes, gjatë procesit zgjedhor.</p>   | <p>Minimum: 10,000 €<br/>Maksimum: 50,000 €</p> | <p>Minimum: 9,000 €<br/>Maksimum: 40,000 €</p> |

### Veprimet e Ndaluar nga Sherbyesit Publik

|  |   |   |
|--|---|---|
| <p>Personi që mban pozitë publike, personi i zgjedhur apo i caktuar, nuk mund të përdorë atë zyrë ose ndonjë nga pasuritë e asaj zyre me qëllim të përfitimit të votave. Asnjë nga burimet e institucioneve të administratës publike, qoftë të nivelit qendror ose lokal, ose edhe ndonjë ndërmarreje në zotërim ose të kontrolluar nga autoritetet qendrore ose lokale, nuk mund të shfrytëzohen ose të futen në mbështetje të ndonjë subjekti politik në zgjedhje.</p> <p>Shënim: Personit që mban pozitë publike apo personit të zgjedhur apo të caktuar i ndalohet të marr pjesë në zgjedhjet e mbajtura nën autoritetin e KQZ-së, si kandidat apo edhe si pjesë administrative e ndonjë organi zgjedhor prej tre (3) viteve deri në gjashtë (6) vite.</p> | <p>Minimum: 10,000 €<br/>Maksimum: 50,000 €</p> | <p>Minimum: 10,000 €<br/>Maksimum: 40,000 €</p> |
|--|---|---|

|  |  |  |
|--|--|--|
| Inkurajimi ose përfitimi nga shërbyesi publik duke përdorur pozitën publike të tij ose të saj për të zhvilluar fushatë për subjektin politik.  | Minimum: 6,000 €<br>Maksimum: 25,000 € | Minimum: 6,000 €<br>Maksimum: 25,000 € |
| Shënim: Personit që mban pozitë publike apo personit të zgjedhur apo të caktuar i ndalohej të marr pjesë në zgjedhjet e mbajtura nën autoritetin e KQZ-së, si kandidat apo edhe si pjesë administrative e ndonjë organi zgjedhor prej tre (3) viteve deri në gjashtë (6) vite. |  |  |

### Veprimet e Ndaluar Para Procesit të Votimit

|  |  |  |
|--|--|--|
| Njëzetekatër (24) orë para hapjes së Qendrave të Votimit për hedhjen e votës, e deri në mbylljen e tyre, shpërndarja ose shfaqja në mënyrë tjetër në ndonjërin nga Qendrat e Votimit, ose 100 metra brenda hapësirës së të njëjtës, e çfarëdo lloj materiali me qëllim ndikimi tek votuesit. | Minimum: 6,000 €<br>Maksimum: 25,000 € | Minimum: 5,500 €<br>Maksimum: 20,000 € |
| Në qoftë se subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij bëjnë fushatë në çfarëdo mënyre njëzetekatër (24) orë para hapjes së Qendrave të Votimit, për hedhjen e votës, e deri në mbylljen e tyre.  | Minimum: 6,500 €<br>Maksimum: 25,000 € | Minimum: 5,500 €<br>Maksimum: 20,000 € |

### Deklarimi i Raportit Financiar të Fushatës

|  |  |  |
|--|--|--|
| Mos-dorëzimi i raporteve financiare sipas afateve të përcaktuara, apo dorëzimi i raportit të pa-kompletuar apo të pasaktë. | Minimum: 6,000 €<br>Maksimum: 20,000 € | Minimum: 6,000 €<br>Maksimum: 20,000 € |
|--|--|--|



## 3.2. KRIMI NË ZGJEDHJE

Siç është përcaktuar në Nenin 1.12 të PZAP Rregullat dhe Procedurat, të gjitha ankesat që kanë të bëjnë me krime zgjedhore, të përmendura në Kapitullin 18 të Kodit Penal të Kosovës, i përcjellen Prokurorisë Shtetërore për hetime të metutjeshme. Pasi që një rast kriminal të jetë përcjellë në Prokurorinë e Shtetit, kalon në përgjegjësinë e tyre që të vazhdojnë procedimin e rastit.

Janë disa nene në Kodin Penal të Kosovës të cilat i përfshijnë dënimet që janë të mundshme për personat të cilët bëjnë krime në zgjedhje.

| AKTI KRIMINAL  | PËRSHKRIMI I AKTIT   |
|--|--|
| <p><b>Cënimi i së drejtës për të kandiduar</b></p> <p><b>Neni 210</b></p>                | <p>1. Kushdo që në mënyrë të kundërligjshme parandalon ose pengon ndonjë person nga kandidimi në zgjedhje, dënohet me gjobë ose me burgim deri në një (1) vit.</p> <p>2. Nëse vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni kryhet me përdorim të forcës apo kanosjes serioze, kryesi dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në tre (3) vjet.</p>   |
| <p><b>Kanosja e kandidatit Article 211</b></p> <p><b>Neni 211</b></p>                    | <p>1. Kushdo që në mënyrë të kundërligjshme detyron ndonjë kandidat që të tërheq kandidaturën e tij, dënohet me gjobë ose me burgim deri në një (1) vit.</p> <p>2. Kushdo që në mënyrë të kundërligjshme parandalon ose pengon ndonjë kandidat nga ushtrimi i ndonjë veprimtarie gjatë fushatës elektorale, dënohet me gjobë ose me burgim deri në një (1) vit.</p> <p>3. Kushdo që kryen vepër penale nga paragrafi 1. ose 2. i këtij neni me përdorim të forcës apo kanosjes serioze, dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në tre (3) vjet.</p>  |
| <p><b>Parandalimi i ushtrimit të së drejtës për të votuar</b></p> <p><b>Neni 212</b></p> | <p>1. Kushdo që gjatë ushtrimit të detyrave të besuara lidhur me zgjedhjet, në mënyrë të kundërligjshme dhe me qëllim të pengimit të personit tjetër nga ushtrimi i së drejtës së tij për të votuar, nuk e regjistron personin e tillë në listën e regjistrimit të votuesve ose e heq personin e tillë nga lista e regjistrimit të votuesve, dënohet me burgim prej një (1) viti deri në tre (3) vjet.</p> <p>2. Kushdo që gjatë votimit ose referendumit, në mënyrë të kundërligjshme parandalon, pengon ose ndikon në përcaktimin e lirë të votuesit ose në ndonjë mënyrë tjetër pengon personin tjetër në ushtrimin e së drejtës së tij për të votuar, dënohet me burgim deri në një (1) vit.</p> <p>3. Kushdo që kryen vepër penale nga paragrafët 1. dhe 2. i këtij neni me përdorim të forcës apo kanosjes serioze, dënohet me burgim prej një (1) vjet deri në pesë (5) vjet.</p> |

|   |  |
|---|--|
| <p><b>Cënimi i përcaktimit të lirë të votuesve</b></p> <p><b>Neni 213</b></p>           | <p>1. Kushdo që me përdorim të forcës apo kanosjes serioze, ose me keqpërdorim të varësisë ekonomike dhe profesionale të votuesit ndikon ose detyron votuesin në Republikën e Kosovës që të votojë në mënyrë të caktuar ose të mos votojë në zgjedhje, dënohet me një (1) deri në pesë (5) vjet burg.</p>  |
| <p><b>Keqpërdorimi i detyrës zyrtare gjatë zgjedhjeve</b></p> <p><b>Neni 214</b></p>    | <p>1. Çdo person zyrtar të cilit i janë besuar detyra lidhur me zgjedhjet, keqpërdor pozitën, detyrën apo autoritetin e tij duke urdhëruar, këshilluar ose kryer ndonjë veprë të kundërligjshme me qëllim të ndryshimit apo ndikimit të listës së regjistrimit të votuesve ose votimit të cilitdo person ose në ndonjë mënyrë tjetër vepron me qëllim që të ndryshojë, ndikojë ose pengojë ndonjë person nga ushtrimi i të drejtës së tij për të votuar, për të mos votuar, për të hedhur një votë të pavlefshme ose për të votuar në favor apo kundër një personi ose propozimi të caktuar, dënohet me gjobë dhe me burgim prej dy (2) deri në pesë (5) vjet.</p>   |
| <p><b>Dhënia ose marrja e ryshfetit në lidhje me votimin</b></p> <p><b>Neni 215</b></p> | <p>1. Kushdo që premtom, ofron ose jep ndonjë përfitim ose dhuratë të pamerituar ndonjë personi, me qëllim që të ndikojë atë person për të votuar, për të mos votuar, për të votuar në favor apo kundër një personi apo propozimi të caktuar ose për të hedhur një votë të pavlefshme në zgjedhje apo në referendum, dënohet me burgim prej një (1) deri në pesë (5) vjet.</p> <p>2. Kushdo që kërkon ose pranon ndonjë përfitim ose dhuratë të pamerituar për vete ose për ndonjë person tjetër, ose pranon ofertën apo premtimin për përfitim apo dhuratë të tillë, për të votuar ose për të mos votuar, për të votuar në favor apo kundër një personi apo propozimi të caktuar ose për të hedhur një votë të pavlefshme në zgjedhje apo në referendum, dënohet me burgim prej një (1) deri në pesë (5) vjet.</p> <p>3. Kushdo që shërben si ndërmjetësues dhe shkel paragrafin 1. ose 2. të këtij neni, dënohet me burgim prej një (1) deri në pesë (5) vjet.</p> <p>4. Nëse vepra penale nga paragrafët 1. deri 3. të këtij neni kryhet nga anëtari i Komisionit Zgjedhor ose ndonjë person tjetër gjatë ushtrimit të detyrave zyrtare në lidhje me votimin, kryesi dënohet me burgim prej tre (3) deri në pesë (5) vjet.</p> <p>5. Dhurata konfiskohet.</p> |
| <p><b>Keqpërdorimi i të drejtës së votimit</b></p> <p><b>Neni 216</b></p>               | <p>1. Kushdo që kryen një ose më shumë nga veprat në vijim, dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në tre (3) vjet:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>1.1 voton ose tenton të voton në emër të personit tjetër;</li> <li>1.2 voton ose tenton të voton edhe pse ka votuar një herë; ose</li> <li>1.3 shfrytëzon më shumë se një listë votimi.</li> </ul> <p>2. Anëtari i Komisionit Zgjedhor i cili i mundëson tjetrit të kryej ose të tentojë të kryej veprën penale nga paragrafi 1. i këtij neni dënohet me burgim prej tre (3) deri në pesë (5) vjet.</p>   |

|   |  |
|---|--|
| <p><b>Pengimi i procesit të votimit</b></p> <p><b>Neni 217</b></p>        | <p>1. Kushdo që në mënyrë të kundërligjshme pengon ose ndërpre në procesin e votimit, dënohet me burgim prej një (1) deri në dy (2) vjet.</p> <p>2. Kushdo që me përdorim të forcës apo kanosjes serioze, pengon votimin me nxitje të prishjes së rendit publik në qendrën e votimit, që rezultojn me ndërprerje në procesin e votimit, dënohet me burgim prej një (1) vjet deri në tre (3) vjet.</p>  |
| <p><b>Cënimi i fshehtësisë së votimit</b></p> <p><b>Neni 218</b></p>      | <p>1. Kushdo që në zgjedhje ose në referendum cenon fshehtësinë e votimit, dënohet me burgim deri në gjashtë (6) muaj.</p> <p>2. Kushdo që me përdorim të forcës apo kanosjes serioze, ose në ndonjë mënyrë tjetër të kundërligjshme kërkon nga personi që të tregojë si ka votuar, dënohet me burgim deri në një (1) vit.</p> <p>3. Kur vepra penale nga paragrafi 1. ose 2. i këtij neni kryhet nga anëtari i Komisionit Zgjedhor ose ndonjë person tjetër në keqpërdorim të detyrave, pozitës apo autorizimeve të tij në zgjedhje ose në votim, kryesi dënohet me burgim prej një (1) deri në pesë (5) vjet.</p>  |
| <p><b>Falsifikimi i rezultateve të votimit</b></p> <p><b>Neni 219</b></p> | <p>1. Kushdo që shton, heq apo fshin votat apo nënshkrimet, regjistron në mënyrë të pasaktë votën apo rezultatet e zgjedhjeve në dokumentet zgjedhore, ose publikon votën apo rezultatet e zgjedhjeve apo të votimit që nuk i përgjigjen votimit të vërtetë, ose në ndonjë mënyrë tjetër falsifikon votën apo rezultatet e zgjedhjeve, dënohet me burgim prej një (1) deri në tre (3) vjet.</p> <p>2. Kur vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni kryhet nga anëtari i Komisionit Zgjedhor ose ndonjë person tjetër në keqpërdorim të detyrave, pozitës apo autorizimeve të tij lidhur me zgjedhjet, kryesi dënohet me burgim prej tre (3) deri në pesë (5) vjet.</p> |
| <p><b>Asgjësimi i dokumenteve të votimit</b></p> <p><b>Neni 220</b></p>   | <p>1. Kushdo që asgjëson, fsheh, dëmton apo merr fletën e votimit ose ndonjë tjetër send apo dokument lidhur me zgjedhjet ose referendumin, dënohet me burgim prej një (1) deri në tre (3) vjet.</p> <p>2. Kur vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni kryhet nga anëtari i Komisionit Zgjedhor ose ndonjë person tjetër në keqpërdorim të detyrave, pozitës apo autorizimeve të tij lidhur me zgjedhjet, kryesi dënohet me burgim prej tre (3) deri në pesë (5) vjet.</p>  |

# ANEKSI A: FORMULARI I ANKESAVE



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

## Formulari i Ankesës

E rezervuar për PZAP-in

NUMRI I REGJISTRIT TË VENDIMEVE \_\_\_\_\_

Shih faqen vijuese për udhëzime të hollësishme lidhur me mënyrën e parashtrimit të ankesave

### A. IDENTIFIKIMI I PARASHTRUESIT TË ANKESËS

Nëse parashtruesi i ankesës është organizatë apo subjekt politik:

1. Emri i organizatës/subjektit politik që parashtron ankesën \_\_\_\_\_
2. Emri i personit të caktuar për kontaktim \_\_\_\_\_
3. Posti i personit të caktuar për kontaktim \_\_\_\_\_
4. Adresa \_\_\_\_\_
5. Komuna \_\_\_\_\_
6. Nr. i telefonit \_\_\_\_\_ 7. Nr. i faksit \_\_\_\_\_
8. E-maili \_\_\_\_\_

Nëse parashtruesi i ankesës është individ:

1. Emri \_\_\_\_\_
2. Përkatësia politike nëse i përket ndonjë subjekti politik \_\_\_\_\_
3. Adresa \_\_\_\_\_
4. Komuna \_\_\_\_\_
5. Nr. i telefonit \_\_\_\_\_ 6. Nr. i faksit \_\_\_\_\_
7. E-maili \_\_\_\_\_
8. Data e lindjes 

|  |  |  |
|--|--|--|
|  |  |  |
|--|--|--|

 / 

|  |  |
|--|--|
|  |  |
|--|--|

 / 

|  |  |  |  |
|--|--|--|--|
|  |  |  |  |
|--|--|--|--|

 9. Numri i regjistrimit civil/ si votues 

|  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |
|--|--|--|--|--|--|--|--|--|--|
|  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |
|--|--|--|--|--|--|--|--|--|--|

### B. KRYESI I SUPOZUAR I SHKELJËS

Nëse kryesi i supozuar është individ/organizatë apo subjekt politik:

1. Emri i individit/organizatës apo subjektit politik \_\_\_\_\_
2. Posti zyrtar i personit, nëse ka të tillë \_\_\_\_\_
3. Adresa \_\_\_\_\_
4. Komuna \_\_\_\_\_
5. Nr. i telefonit \_\_\_\_\_ 6. Nr. i faksit \_\_\_\_\_
7. E-maili \_\_\_\_\_

### C. SHKELJA/ SHKAKU I ANKESËS

Pershkrimi ankesën tuaj në hollësi, duke përfshirë vendin, datën dhe kohën e shkeljes së pohuar. Lutemi ta përshkruani natyrën e shkeljes dhe nëse është e mundur të specifikoni dispozitat ligjore që mendoni se janë shkelur. Nëse është e nevojshme, mund të bashkëngjini fletë shtesë. Bashkëngjitur dërgoni kopjet e çfarëdo dëshmie që mbështet ankesën tuaj.

### D. DËSHMITARI (ËT) E MUNDSHËM (BASHKANGJITUR EDHE DEKLARATAT)

Lutemi të shënojmë emrin dhe organizatën ose subjektin politik të cilit i përket dëshmitari(ët) i/e mundshëm. Nëse është e mundur, duhet të shënohen të dhënat për kontaktin (adresa, numri i telefonit, numri i faksit dhe e-maili). Nëse është e nevojshme, mund të bashkëngjini fletë shtesë.

Sipas njohurive që une posedoj, informacioni i mësipërm është i saktë:  
(Nëse parashtruesi i ankësës është organizatë ose subjekt politik, atëherë atë duhet ta nënshtrojë përfaqësuesit (autorizuar)

Emri dhe Mbiemri \_\_\_\_\_

Nënshtkrimi \_\_\_\_\_

Data \_\_\_\_\_

Ky informacion duhet të dorëzohet në adresën: Paneli Zgjidhës për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)  
Rruga "Luan Haradinaj", Ndërtesa e ish Bankës së Luogjames - Kati I  
Prishtinë 10 000 Republika e Kosovës

### PARASHTRIMI I ANKESAVE PRANË PZAP-it

Cdo person, i cili ka interes ligjor ose që pohon se i janë shkelur të drejtat që kanë të bëjnë me procesin e zgjedhjeve, mund të parashtrtojë ankesën pranë Panelit të Zgjedhjeve për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP). Kjo në mes tjerash, përfshih, por nuk kufizohet në:

- Aftëkëmbësit;
- Votuesit;
- Partitë politike, koalicionet, iniciativat votuese dhe kandidatët e certifikuar;
- Anëtarët e KQZ-së dhe të Sekretariatit të tij;

Për të parashtruar ankesë, duhet të plotësohet formulari i PZAP-it për ankesa. Formulari i ankësive është në dispozicion në gjuhën Shqipe dhe Serbe, në zyrën e PZAP-it në Prishtinë, si dhe në të gjitha Qendrat e Votimeve gjatë ditës së zgjedhjeve.

Që të shqyrtohet kjo ankesë, ajo duhet të përmbajë informatat vijuese:

- Pothim mbi shkeljen e një rregullore të zgjedhjeve, ose të ndonjë urdhërese administrative që ka të bëjë me procesin zgjedhës;
- Përshkrimin sa më të hollësishtë të pohlmit mbi shkeljen/incidentin; dhe
- Nënshtkrimin në formular që tregon se të dhënat janë të sakta sipas njohurisë së parashtruesit të ankësës.

Duhet të plotësohen të gjitha rubrikat e zbatueshme të formularit. Nëse ndonjë rubrikë nuk mund të zblohet, atëherë duhet të shënohet si "e pazbatueshme".

faqja me adresë të jepen të dhënat për kontaktim të parashtruesit të ankësës, në mënyrë që PZAP-i mund të kontaktojë me parashtruesin e ankësës të rastit hetimi dhe pasi të jetë marrë vendimi përfundimtar përkatëz në ankesë.

Për të gjitha çështjet që nuk lidhen drejtpërdrejt me votimin dhe numërimin, ankesa duhet të parashtrohet brenda tri ditësh pas pohlmit mbi shkeljen ose pasi të jetë i informuar parashtruesi i ankësës për atë shkelje.

Personi i cili ka interes ligjor në një çështje brenda juridiksionit të PZAP-it, ose të drejtat e të cilit janë shkelur për sa i përket procesit zgjedhës të rregulluar sipas Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme ose rregullave zgjedhëse, mund të paraqesë ankesë.

Ankesat lidhur me administrimin e numërimit në Qendren e Numërimit dhe Rezultative (QNR) dorëzohen me shkrim pranë PZAP-it brenda njëzetekatër (24) orëve nga ndodhja e shkeljes së sapozuar.

Parashtrimi i ankësës bëhet drejtpërdrejt në zyrën qendrore të PZAP-it në Prishtinë. Po ashtu ankesat mund të lihen në kutitë postare të PZAP-it që gjenden në Prishtinë dhe në Zyrën e Sekretariatit të PZAP-it. Vendimet përfundimtare të PZAP-it bëhen publike; megjithatë dosjet e fletëve mbeten plotësisht konfidenciale dhe të gjitha hetimet janë konfidenciale.

# ANEKSI B: DIAGRAMI PËR ANKESA DHE APELE

